

UDHËZIM
Nr. 5, datë 11.3.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS NR. 14, DATË 9.7.2013, “PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, SI EDHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË KËTO INSTITUCIONE PËR VITIN AKADEMIK 2013-2014”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” dhe nenit 35 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 12 e udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 9.7.2013, të ndryshojë, si më poshtë:

“Transferimi i studimeve nga institucionet publike të arsimit të lartë në institucionet private të arsimit të lartë, si dhe ndërmjet vetë institucioneve të arsimit të lartë privat, të kryhet sipas kriterëve të përcaktuara në statutet e institucioneve dhe rregulloren e njësisë kryesore, ku bëhet transferimi i studimeve dhe të realizohet në dy faza:

- a) Faza e parë: 1 gusht 2013 - 15 nëntor 2013.
- b) Faza e dytë: 15 shkurt 2014 - 15 mars 2014.”.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë privat.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla